



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 763 Akti

Nr. 798 Vendimi

Tiranë, më 10.09.2024

V E N D I M

Trupi gjyqësor i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Lulzim Hamitaj	Kryesues
Etleda Çiftja	Relatore
Firdes Shuli	Anëtare

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Resilda Bilaj, në prezencë edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Ferdinando Buatier, në datën 10.09.2024, mori në shqyrtim mbi bazën e dokumenteve të administruara çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Znj. Monika Çuhadari**, me detyrë këshilltare ligjore pranë Gjykatës së Lartë.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni G i Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;**

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar;

Vendimi nr. 78, datë 12.12.2017, i Gjykatës Kushtetuese.

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes, komisioneren Etleda Çiftja, mori në shqyrtim dhe analizoi vendimin nr. ***, datë 11.7.2024, të Këshillit të Lartë të Gjyqësor, me të cilin është vendosur përfundimi i marrëdhënies në shërbimin civil gjyqësor të znj. Monika Çuhadari për shkak të dorëheqjes, si dhe pasi bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. Rrethanat procedurale

1. Znj. Monika Çuhadari, në momentin e hyrjes në fuqi të nenit 179, shkronja “b” e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, ka mbajtur funksionin e këshilltares ligjore në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Lartë, për rrjedhojë, në zbatim të pikës 4 të kësaj dispozite dhe parashikimit të nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016, gëzon statusin e subjektit të rivlerësimit dhe i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio*.
2. Subjekti i rivlerësimit Monika Çuhadari, bazuar në nenin 14 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit, duke u shortuar në datën 15.6.2021, me trupin gjykues të përbërë nga komisionerët Firdes Shuli, Lulzim Hamitaj dhe Etleda Çiftja.
3. Menjëherë pas hedhjes së shortit u administruan raportet e vlerësimit të hartuara nga: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI), sipas neneve 31 - 33 të ligjit nr. 84/2016; Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (ish-DSIK), sipas neneve 34 - 39 të ligjit nr. 84/2016; Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim KLGJ), sipas neneve 40 - 44 të ligjit nr. 84/2016.
4. Trupi gjykues i shortuar në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, me vendimin datë 21.6.2021, pas studimit të raporteve të sipërpërmendura të vlerësimit të hartuara nga institucionet shtetërore, vendosi të fillojë hetimin administrativ të thellë dhe të gjithanshëm sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit dhe të caktojë kryesues të trupit gjykues komisionerin Lulzim Hamitaj. Të gjithë anëtarët deklaruan mosqenien në kushtet e konfliktit të interesit.
5. Në datën 26.7.2021, subjekti i rivlerësimit u njoftua nëpërmjet postës elektronike¹ mbi fillimin e procesit të rivlerësimit kalimtar, si dhe përbërjen e trupit gjykues. Subjekti i rivlerësimit nëpërmjet postës elektronike² deklaroi marrjen dijeni dhe mosqenien në kushtet e konfliktit të interesit.
6. Subjekti i rivlerësimit me anë të postës elektronike³ depozitoi pranë Komisionit përgjigjet e pyetësorit standard bashkë me provat shkresore.
7. Në datën 1.7.2024, me anë të postës elektronike⁴, subjekti i rivlerësimit njoftoi se ka paraqitur kërkesën për dorëheqje/ndërprerjen e marrëdhënies së punës përpara Këshillit të Lartë Gjyqësor, duke bashkëlidhur edhe kopje të kërkesës. Subjekti deklaroi se është në proces të mbledhjes/grumbullimit të dokumentacionit të nevojshëm ligjor për efekt të pensionit të pleqërisë.
8. Më tej, në datën 16.7.2024, Komisioni administroi shkresën nr. *** prot., datë 16.7.2024, të KLGJ-së, me anë të së cilës u njoftua se është marrë vendimi nr. ***, datë 11.7.2024, ku është

¹ Email datë 26.7.2021, ora 14:42 “Njoftim për fillimin e procesit të rivlerësimit dhe kërkesë për informacion shtesë”.

² Email datë 28.7.2021, ora 12:03 “Njoftim për fillimin e procesit të rivlerësimit dhe kërkesë për informacion shtesë”.

³ Email datë 9.9.2021, ora 16:00 “Përgjigjet e pyetësorit standard”.

⁴ Email datë 1.7.2024, ora 15:08 “Re: Komisioni - pyetësor nr. 2 për procesin tuaj të rivlerësimit”.

vendosur përfundimi i marrëdhënies në shërbimin civil gjyqësor të znj. Monika Çuhadari për shkak të dorëheqjes dhe bashkëlidhur kësaj shkrese dërgoi kopjen e vendimit.

9. Bazuar në këtë vendim, Komisioni vëren se në datën 1.7.2024 znj. Monika Çuhadari ka depozituar pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor kërkesë për dorëheqje nga detyra e këshilltarit ligjor pranë Njesisë së Shërbimit Ligjor në Gjykatën e Lartë. Bazuar në të dhënat që disponon Drejtoria e Burimeve Njerëzore pranë KLGJ-së, rezultoi se znj. Monika Çuhadari, e datëlindjes 9.2.1963, nëpunës civil gjyqësor, referuar ligjit nr. 98/2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 50, shkronja “b”, në zbatim të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, mbush moshën për pension të plotë pleqërie në datën 9.10.2024. Megjithatë, znj. Çuhadari ka paraqitur kërkesën e ligjshme, referuar vendimit nr. ***, datë 5.6.2024, mbi miratimin e rregullores “Për pezullimin dhe ndërprerjen e marrëdhënies në shërbimin civil gjyqësor” të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

10. Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 80 të ligjit nr. 98/2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ka në kompetencë të tij ndër të tjera ndërprerjen e marrëdhënies në shërbimin civil gjyqësor për pozicionin e këshilltarit ligjor. Në nenin 12, pika 1 e vendimit nr. 289, datë 5.6.2024, mbi miratimin e rregullores “Për pezullimin dhe ndërprerjen e marrëdhënies në shërbimin civil gjyqësor” të Këshillit të Lartë Gjyqësor, përcaktohet se: *“1. Marrëdhënia e shërbimit civil gjyqësor ndërpritet me vendim të: a) Këshillit të Lartë Gjyqësor për kancelarin, këshilltarin dhe ndihmësin ligjor”*⁵.

11. Sa më sipër, mbështetur në nenin 80 të ligjit nr. 98/2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenin 16 të vendimit nr. 289, datë 5.6.2024, mbi miratimin e rregullores “Për pezullimin dhe ndërprerjen e marrëdhënies në shërbimin civil gjyqësor” të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe kërkesën e ligjshme të znj. Monika Çuhadari, vlerësohet përfundimi i marrëdhënies në shërbimin civil gjyqësor, në datën 31.7.2024. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

II. Verifikimi i vullnetit të pavesuar për dorëheqje

12. Komisioni konstatoi se Këshilli i Lartë Gjyqësor, me shkresën nr. *** prot., datë 28.8.2024, ka bërë me dije se subjekti i rivlerësimit nuk ka ushtruar të drejtën e ankimit ndaj vendimit nr. ***, datë 11.7.2024, të KLGJ-së, për pasojë, ky vendim ka marrë formë të prerë.

13. Për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor dhe të drejtës që gëzon subjekti i rivlerësimit për t’u dëgjuar, bazuar në nenin 55 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, me anë të postës elektronike⁶, i ka kërkuar subjektit të shprehet nëse ka vullnetin e saj të pavesuar për t’u dorëhequr ose të deklarojë në seancë dëgjimore publike dhe/ose me anë të postës elektronike lidhur me përfundimin e procesit të rivlerësimit, në zbatim të paragrafëve 1 dhe 2 të nenit G të Aneksit të Kushtetutës. Për këtë arsye

⁵ Referuar nenit 16 të vendimit nr. 289, datë 5.6.2024, mbi miratimin e rregullores “Për pezullimin dhe ndërprerjen e marrëdhënies në shërbimin civil gjyqësor të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, përcaktohet se: *“Nëpunësi civil gjyqësor mund të njoftojë përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil gjyqësor nëpërmjet paraqitjes së dorëheqjes me shkrim tek Këshilli i Lartë Gjyqësor për kancelarët, këshilltarët dhe ndihmësit ligjorë dhe tek Këshilli i Gjykatës për nëpunësit e tjerë. 2. Dorëheqja nuk motivohet dhe i prodhon efektet 30 ditë nga data e paraqitjes së saj”*.

⁶ Email datë 4.9.2024, ora 13:18 “Komisioni – Konfirmim lidhur me vullnetin e lirë për t’u dorëhequr”.

i kërkoi subjektit të shprehte në mënyrë të qartë dhe të pavesuar vullnetin mbi dorëheqjen nga detyra në seancë dëgjimore ose me anë të postës elektronike.

14. Subjekti i rivlerësimit Monika Çuhadari, me anë të postës elektronike⁷, deklaroi se: “*Ndaj këtij vendimi nuk kam ushtruar ankim, pasi kam vlerësuar se është marrë në zbatim të drejtë të ligjit. Lidhur me vijimin e procesit të rivlerësimit që ju jeni duke ezauruar, ju rikonfirmoj përsëri se jam në ditët e fundit të plotësimit të moshës për të dalë në pension pleqërie. Jam në dijeni të plotë të parashikimeve ligjore në raste të tilla, kur procesi i rivlerësimit ndërpritet për shkak të dorëheqjes dhe ju konfirmoj se në kushtet ligjore dhe faktike që ndodhem (mbushjes së moshës për përfitimin e pensionit të pleqërisë) vlerësoj se nuk kam arsye të kundërshtoj ndalesat që parashikon ligji për 15 vitet e ardhshme. Së fundi, ju konfirmoj se nuk gjej arsye për t’u paraqitur në seancë dhe deklaruar më tepër se sa kam parashtruar më sipër në këtë email”.*

15. Sa rezulton, subjekti konfirmoi se nuk dëshiron të paraqitet në seancë dëgjimore dhe konfirmoi sërish vullnetin e saj të lirë dhe të pavesuar në lidhje me dorëheqjen e saj të parashtruar dhe të miratuar nga KLGJ-ja.

III. Arsyet e përfundimit të procesit të rivlerësimit

16. Procesi i rivlerësimit që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b të Aneksit të Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

17. Trupi gjykues i Komisionit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes bazuar në provat e administruara më lart, konstaton se: (i) Subjekti i rivlerësimit Monika Çuhadari ka ushtruar funksionin e këshilltares ligjore pranë Gjykatës së Lartë në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016; (ii) Subjekti i rivlerësimit ka ushtruar të drejtën për të dhënë dorëheqjen pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016; (iii) Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil për shkak të dorëheqjes; (iv) Subjekti i rivlerësimit nuk e ka ankimuar pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë vendimin nr. ***, datë 11.7.2024, të KLGJ-së; (v) Komisioni kërkoi konfirmimin e shprehjes së vullnetit të subjektit në lidhje me dorëheqjen, si dhe i bëri me dije pasojat që vijnë nga kjo dorëheqje sipas parashikimeve të nenit G të Aneksit të Kushtetutës; (vi) Subjekti i rivlerësimit konfirmoi me *email* se dorëheqja është me vullnet të lirë e të pavesuar dhe nuk dëshiron të paraqitet në seancë dëgjimore publike.

18. Trupi gjykues i Komisionit çmon se referuar fakteve të evidentuara më lart procesi i rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit Monika Çuhadari duhet të ndërpritet sipas nenit G të Aneksit të Kushtetutës.

19. Për sa më sipër, në referim të shkronjës “b” të nenit 89 të Kodit të Procedurave Administrative, Komisioni vlerëson se procedura administrative për këtë subjekt mund të mbyllet pa nevojën e zhvillimi të seancës dëgjimore.

IV. Orientimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit⁸

⁷ *Email*, datë 6.9.2024, ora 13:07.

⁸ Referojuni vendimit nr. 1/2018 (JR), datë 11.6.2018, paragrafëve 96 dhe 97 të Kolegjit.

20. Kolegji i Posaçëm Apëlimit, në lidhje me praktikën e gjyqimit të çështjeve që lidhen me institutin e dorëheqjes së subjekteve të rivlerësimit nga procesi në fazën të ndryshme të tij, po kështu edhe pasojat juridike që sjell ndërprerja e procesit, orienton Komisionin që për zgjidhjen e këtyre çështjeve, duke respektuar parimin e transparencës në zhvillimin e procedurës së rivlerësimit, të verifikojë vullnetin e pavesuar për dorëheqjen e dhënë, e cila duhet të ketë burim të ligjshëm një prej institucioneve të caktuara me ligj.

21. Trupi gjyqësor mban parasysh jurisprudencën e deritanishme të Kolegjit, sipas së cilës akti i dorëheqjes së subjektit të rivlerësimit sjell si pasojë humbjen e statusit të tij si subjekt rivlerësimi *ex officio* në kuadër të përcaktimit kushtetues të nenit 179/b të Kushtetutës, si dhe pamundësinë e realizimit të qëllimit të procesit të rivlerësimit, duke pasur parasysh që, referuar nenit 58, pika 1, nënparagrafët “a”, “b” e “c” të ligjit nr. 84/2016, qëllimi për kryerjen e procesit të rivlerësimit, i parashikuar në pikën 1 të nenit 179/b të Kushtetutës, realizohet përfundimisht nëpërmjet konfirmimit në detyrë apo shkarkimit nga detyra të subjektit të rivlerësimit. Vullneti për të mos iu shmangur procesit të rivlerësimit sipas përcaktimit të tij në dispozitat kushtetuese dhe ligjin nr. 84/2016, shprehet vetëm nëpërmjet qëndrimit në detyrë dhe përfundimit të procesit të rivlerësimit. Në momentin që subjekti i rivlerësimit me vullnetin e tij të lirë ndërpret detyrën funksionale që e bën atë subjekt të procesit të rivlerësimit *ex officio*, duhet të marrë parasysh edhe pasojën ligjore që sjell dorëheqja nga detyra në ecurinë e procesit të rivlerësimit, sipas nenit G⁹ të Aneksit të Kushtetutës. Në të njëjtën frymë arsyetohet edhe Gjykata Kushtetuese në vendimin e saj nr. 78, datë 12.12.2017, tek shprehet: “Gjykata thekson se për sa kohë që subjekti i rivlerësimit është në detyrë dhe procesi i rivlerësimit nuk ka përfunduar ende, ai ka të drejtën të japë dorëheqjen dhe në këtë rast procesi i rivlerësimit ndërpritet, duke u zbatuar parashikimet e nenit G të Aneksit të Kushtetutës”.

22. Ky është një qëndrim i unifikuar i Kolegjit të Posaçëm të Apëlimit në vendimmarrje të mëparshme, sipas së cilave orientohet Komisioni që përveç ndërprerjes së procesit të rivlerësimit të vendosë edhe ndalimin e emërimit të subjektit të rivlerësimit sipas nenit G, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës.

23. Sa rezulton, trupi gjyqësor i Komisionit arrin në përfundimin se për sa kohë dorëheqja e subjektit të rivlerësimit përmbush kriteret e përcaktuara në nenin G të Aneksit të Kushtetutës, atëherë pasojat juridike që i atribuohet situatës faktike të parashikuar në këtë nen do të duhet të zbatohet në tërësinë e saj duke i kufizuar të drejtën për t’u emëruar gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare.

⁹ Neni G i Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ka parashikuar mundësinë e subjektit të rivlerësimit për të dhënë dorëheqjen, si vijon: “1. Subjekti i rivlerësimit mund të japë dorëheqjen nga detyra dhe në këtë rast procesi i rivlerësimit ndërpritet. 2. Subjekti i rivlerësimit që dorëhiqet sipas kësaj dispozite, nuk mund të emërohet gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare”.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, mbështetur në nenin G të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenin 57 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Të deklarojë ndërprerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit Monika Çuhadari, me detyrë këshilltare ligjore pranë Gjykatës së Lartë.
2. Ndalimin e emërimit të znj. Monika Çuhadari si gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare.
3. Ky vendim u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
4. Kundër këtij vendimi lejohet ankimi në Kolegjin e Posaçëm të Apelit brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të tij.
5. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 10.09.2024.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Lulzim HAMITAJ
Kryesues

Etleda ÇIFTJA
Relatore

Firdes SHULI
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Resilda Bilaj